

Kisha te restauruara



Manastiri i Kryeengjëjve Mihail dhe Gavriil, Derviçan – Gjirokastrë

Manastiri i Kryeengjëjve ngrihet në pllajën e Malit të Gjerë mbi fshatin Derviçan. Është një ndërtim më i ri në krahasim me komplekset e tjera të manastireve të kësaj lugine. Megjithatë ka vlera, sepse dëshmon për ecurinë e zhvillimit dhe larminë tipologjike të ndërtimeve manastirore të arkitekturës pasbizantine.

Kompleksi i manastirit përbëhet nga kisha dhe konakët, që e rrethojnë atë, kryesisht nga ana lindore dhe perëndimore. Nga këto ndërtime ruhet në gjendje relativisht të mirë kisha, ndërsa konakët janë thuajse në gjendje të rrënuar. Në të gjithë sipërfaqen e interiorit, kisha mban pikturë murale. Nga lëvizjet e dherave në zonën veriore ishin konstatuar çarje të harqeve në harkadën perëndimore, në zonën e harkadës para Hijerores, në qemerin e prothesis etj.

Punimet, që u kryen fillimisht në periudhën 2001-2003, konsistuan në çeljen e

rrugës për në manastir me gjatësi 2 km, puntelimin e harkadave të dëmtuara, rehabilitimin e konstruksionit të mbulesës së brendshme dhe rindërtimin e konstruksionit të drurit të çatisë. Gjatë vitit 2010 në kishë u kryen ndërhyrje restauruese, të cilat përfshinë përforcimin e themeleve, vendosjen e elementeve lidhëse metalike për shëndoshjen e aftësisë mbajtëse, rikonstruksionin e plotë të çatisë, pastrimin dhe konsolidimin e pikturës murale, riparimin e dyshemesë dhe shtrimin e saj me pllaka natyrore. Gjithashtu, punime u kryen për sistemimin e ambientit përreth dhe nër plotësimin e mureve rrethuese



ërisë me





[Kisha Orthodoxke Autoqefale e Shqipërisë](#)